



R* PUBLIKA * SHQIPERISE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare
Tirane

Numri i Çështjes 31138-02612-80-2020 Data e Regjistrimit 7/3/2020
Numri i Vendimit 80-2020-2587 Data e Vendimit 10/30/2020

V*NDIM*

N* M * R * T * R * PUBLIKES *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane P * R B * R * NGA:

KRY * S U * S : * * Gentian Hamiti

ANËTAR

S * K R * T A R * * * * * Olta Saliasi

Objekti: 1. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks * * * * * , rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", te Ministrit te * * * * * .

Baza Ligjore : Nenet 41 dhe 42 te Kushtetues se Republikes se Shqiperise; Neni 6 dhe 13 i Konventes * * * * * ; Nenet 149 e 153 te Kodit Civil; Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise; Ligji nr. 27/2018, "Per trashegimine kulturore dhe muzete"; Ligji nr. 49/2012, date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar.

Përmbledhja e vendimit:

.

Vëren:

V È R * * * * *

Se paditësi * * * * * ka paraqitur para kësaj gjykate kërkespadinë me objekt; 1. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks * * * * * , rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", te Ministrit te * * * * * . 2. Shfuqizimin e vendimit nr.130 datë 08.05.2020 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, me nr.616/1 prot datë 08.05.2020. 3. Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore (objekti i ndryshuar i kërkespadiës).

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se, paditësi * * * * * është pronar i pasurisë së paluajtshme të llojit shtëpi banimi, te ndodhur ne Rrugen "Hoxha Tahsim", me nr. pasurie 2/209, regjistruar ne vol. 26, faqe 191, Zona Kadastrale 8150, Tirane.

Në këtë pasuri të paluajtshme ka jetuar i ndjeri Maks * * * * * , i cili ka qenë në lidhje fisnore me paditësin * * * * * .

Me vendimin nr.130 datë 08.05.2020, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka vendosur:

- Miratimin e deklarimit pasuri kulturore e objektit "Banesa ku ka jetuar Maks * * * * * , rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane".



R* PUBLIKA * SHQIPERISE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Ndërsa me urdhrin nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****; rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", *****
***** ka urdhëruar:

1. Deklarimin pasuri kulturore, Monument Kulture Kategorise ***** te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****; rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane"...

Duke e konsideruar këto akte administrative të paligjshme, paditësi i është drejtuar gjykatës duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se; - Paditësi i është cënuar e drejta e pronësise se tij, ne kuptim te percaktimeve te nenit 41 dhe 42 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Jo vetem qe u kufizua e drejta e pronësise por u cëna pa nje proces te rregullt ligjor, sipas neni 42, pagrafi i ***** Kushtetutes se Republikes se Shqiperise. Nga ana e paleve te paditura, nuk eshte respektuar asnje nga parimet e percaktuara ne kete akt ligjor, konkretisht nga neni 4 deri ne nenin 21 te tij. Konkretisht nuk eshte respektuar parimi i ligjshmerise, parimi i transparency, parimi i informimit, parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit, parimi i proporcionalitetit, i drejtesise dhe paanesise, parimi i objektivitetit, pergjegjesise dhe deburokratizimit dhe i efifcences. Procedura administrative, sikunder e parashikon dhe ligji i posaqem per mbrojtjen e trashegimise kulturore mund te nise kryesisht ose me kerkese te ndonje pale te interesuar. Nga korrespondenca qe kemi pasur me palen e paditur ky moment nuk eshte sqaruar asnjehere edhe pse kjo pale e ka detyrim ligjor te jete transparente me palet e interesuara. Ne vleresimin tone, gjithmone duke aluduar, si pronar i vetem i pasurise, paditesi eshte i vetmi person qe mund te legjitimohet per te nisur nje procedure te tille, dhe nderkohe qe ky i fundit nuk ka here asnje kerkese, atehere mund te presupozojme se fillimi i procedures administrative ka qene me initiative te organit publik. Paditesi, jo vetem qe nuk eshte njoftuar per proceduren, per te drejtat apo per qellimet e organeve te administrates publike, por nuk eshte njoftuar as per vendimmarrjen e tyre, qe cenonte drejtperdrejt nje te drejte kushtetuese, sikunder eshte ajo e te drejtes se pronësise. Ne nje proces te rregullt ligjor, sigurisht qe palet e interesuara, kane dhe disa te drejta, sikunder organi publik ka dhe detyrime, si percaktohet ne nenet 45, 47, 48, 53, 71 e vijues. Sigurisht qe nje procedure administrative ka dhe nje proces hetimor administrativ, degjese me palet, e nje sere procedurash te tjera, qe sikunder parashtruam me siper, palet e paditura as ndoshta i njohin, jo me ti zbatojne.

-Nga pikpamja formale, akti administrativ, konkretisht akti i kontestuar, duhet te jete i arsyetuar dhe per shkak se jemi perpara ushtrimit te diskrecionit nga ana e organit publik, ky i fundit duhet dhe te na shpjegonte, konform percaktimeve te nenit 99 dhe 100, shpjegimin pse diskrecioni eshte perdorur ne menyren e percaktuar. Ne keto kushte dhe per nje seri arsyesh te tjera, qe Kodi i Procedures Administrative permban, per shkak se ne rasitn konkret nuk eshte respektuar asnje dispozite e tij dhe do duhej cituar i gjithi, ne vleresojme se akti administrativ i nxjerre nga pala e paditur nuk eshte ne perputhje me parimet dhe kerkesat ligjore te parashikuara ne K.Pr.Administrative ne kuptim te percaktimeve te nenit 107 dhe 109, te ketij Kodi. Vleresojme te domosdoshme te ndalemi pak dhe tek ligji i posacem dhe detyrimet qe percakton ky ligj per organet shteterore. Ne nenin 5, te ligjir nr. 27/2018, percaktohet midis te tjerash se: "Monument kulture " eshte objekti ose ndertimi me vlera historike - kulturore, qe mbrohet nga shteti. Ne kuptim te ketij ligji, ne baze te intensitetit te nderhyrjes ne pasurite kulturore, keto te fimdit kategorizohen ne: a) "Monument kulture i kategorise ***** ndertimi me vlera te spikatura dhe me rendesi te vecante per trashegimime kulturore, i cili ruhet ne teresine e perberesve te tij arkitektonike dhe teknike. Kompozimi i vellimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve te jashtme e te brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e ketyre monumenteve nuk mund te ndryshohen. b) "Monument kulture i kategorise ***** eshte ndertimi me vlera te spikatura kryesisht per pamjen e tij te jashtme, i cili ruhet ne vellime dhe perberje arkitektonike te ketyre pamjeve te jashtme". Sikunder rezulton nga akti i kontestuar ne kete padi, pasuria e paluajtshme e paditesit, eshte deklaruar Monument Kulture i Kategorise ***** . Ne te dy shkresat e derguara



R* PUBLIKA * SHQIPERISE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

nga ana e pales se paditur, sqarohet se: ***** duke vleresuar figuren, kontributin profesional, te intelektualit, artistit, arkitektit dhe shkrimtarit Maks *****; si dhe per te mbajtur gjalle kujtimin epersonalitetit te shquar {...}, pra ne njefare menyre ka dhene arsyen se perse ka arritur ne kete vendimmarrje. Sigurisht, qe ne vleresimin tone modest, por edhe per aq sa e kemi njohur kete personalitet, qendrimi i pales se paditur eshte i admirueshem edhe pse i vonuar dhe pas vdekjes, por nuk kuptojme se qfare lidhje ka ndertesa ne pronesi te paditesit me te gjitha keto qe parashtron kjo pale e paditur. Sikunder rezulton qarte nga ligji, qe nje ndertese te konsiderohet Monument Kulture e kategorise se ***** , duhet qe ndertimi te kete vlera te spikaturaper pamjen e tij te jashtme. Paditesi, sigurisht qe e ka perzemer shtepine e tij, por kur e ka ndertuar nuk ka pasur ndonje arkitekt te njohur dhe nuk i rezulton qe kjo ndertese te kete ndonje vlere te spikatur per pamjen e saj te jashtme. Gjithashtu, ajo nuk ka qene veper arkitektonike e xhaxhait te tij, te ndjeri Maks *****. Ne themel, nuk e kuptojme kete vendimmarrje te pales se paditur, ndoshta dhe per mungesen e informacionit, por ne vleresojme se ndoshta do ishte me mire te deklarohet nje monument kulture nje godine e arkitektuar nga z. ***** dhe jo nje shtepi qe nuk ka asnje vlere arkitektonike. Gjithashtu rezulton e paqarte se si mund te deklarohet pasuri kulturore nje objekt banese private, kur jo vetem nuk ke kryer asnje verifikim, por nuk ke identifikuar dhe vleresuar asnje nga veprat e z. *****. Nuk e kuptojme se si ky proces mund te ndodhe paraprakisht, kur ne fakt duhet te ishte nje proces invers. Kuptojme qe kjo nisme erdhi si pasoje e nje emocioni te momentit dhe ndoshta per te treguar se sa shume e donim dhe vleresonim te ndjerin xhaxha, por duket qartazi qe eshte nje nisme jo vetem e pamenduar mire, por ne kufijte e talljes dhe te papergjegjshmerise. Keto veprime, kaq cinike dhe te paligjishme, jane dhe vertet qesharake. Nuk mund ta besoj askush qe brenda dites, u kryen konsultimet me bashkepronaret, u vizionua ndertesa, u mblodh ***** , u mblodhen 15 anetaret e Komitetit dhe vendosi Ministria, kuptohet qarte qe fdo veprim apo mosveprim eshte fiktiv dhe i pamenduar mire. Per fat te keq keto veprime apo mosveprime kane pasoja te renda per paditesin. Nje fakt tjeter i rendesishem qe vlen per tu permendur eshte dhe fakti se e gjitha kjo, ndodhi ne mes te nje pandemie boterore, si pasoje e perhpajes se Covid - 19, ku dhe paditesi, i cili eshte i vetmi pronar i ligjshem i kesaj pasurie, e ka te pamundur qe te vije personalisht dhe te verifikojte apo te kryeje veprimet e domosdoshme ne lidhje me keto vendimmarrje.

-Pala e paditur, edhe pse ne asnje moment nuk ka qene transparente me paditesin, nuk harron ti kujtoje ketij te fundit, kur ky nis interesimin, se ai ka disa detyrime, por nuk sqaron ne asnje moment se si mund te permbushen keto detyrime kur pronari eshte shtetas amerikan dhe jeton ne SHBA. Ne asnje moment nuk sqaron se cfare detyrimesh konkrete duhet te zbatoje pronari, a duhet te ruaje godinen, fasaden, ambientin e brendshem, ndonje veper te z. *****; asgje konkrete por nje papergjegjshmeri totale, e nje organi publik, i cili vepron me emocione dhe urdhra te momentin dhe jo ne respektim te ligjit. Ne lidhje me proceduren e percaktuar ne ligjin e posacem, konkretisht ne nenin 62 dhe 65 te ligjit nr. 27/2018, pala e paditur ka vepruar duke mos respektuar asnje dispozite te ketyre percaktimeve ligjore.

Pala e paditur ***** e Kulturës dhe avokatura e shtetit, në mënyrë të përmbledhur kanë prapësuar se: -realizimi i tre akteve, shkurtimisht, shkresa 883 Prot. Date 08.05.2020, nga ***** i Trashegimise Kulturore; Vendimi qarkullues nr. 130, date 08.05.2020, nga ***** i Trashegimise Kulturore Materiale; Urdhri nr. 163, date 08.05.2020, te Ministrit te ***** , eshte bere ne perputhje me nenet 57, 58, 59, 60, 61 dhe nenin 62, te ligjit 27/2018, i cili eshte dhe baza ligjore autorizuese per nxjerrjen e urdherit. Ndonese sipas pales paditese aktet e cituara me lart kane dale "pa asnje lloj kerkese", bejme me dije Z. ***** , si dhe gjykaten se pasuria ne pronesi te pales paditese eshte deklaruar si monument kulture, mbi bazen e nje kerkese te iniciuar me propozim te KKTKM. Kjo kerkese ka ndjekur dhe respektuar gjitha proceduren qe parashikojne neni 62 i ligjit 27/2018. Keshtu, eshte e qarte



R* PUBLIKA * SHQIPERISE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

se ligji parasheh se deklarimi i nje pasurie monument kulture mund te behet jo vetem me kerkese por dhe me iniciative. Me tej, pala paditese pretendon se me shkresen nr. 2159 Prot. date 20.05.2020, percjelle nga ***** e ***** , nuk mori informacion shtese, duke i cenuar te drejten e informimit, nderkohe qe eshte e pavertete pasi permes kesaj shkrese MK ka vene ne dijeni palen paditese jo vetem mbi urdhrin qe eshte marre per deklarimin e pasurise se paluajtshme (shtepi banimi) si monument kulture, por gjithashtu e ka informuar se kush ishte organi propozues (iniciues) per nisjen e procedurave per verifikimin dhe deklarimin e pasurise si monument kulture, duke e informuar gjithashtu se ne mbeshtetje dhe kuptim te ligjit 27/2018, "deklarimi si pasuri kulturore nuk ka ndikim ne titullin epronesisë".

Pra, sikur shihet, se pari eshte e pavertete pretendimi se MK nuk ka dhene informacion mbi urdhrin e nxjerre, dhe nga ana tjeter bie poshte pretendimi kur thuhet se eshte mohuar e drejta e informimit, ne fakt e verteta qendron se MK ka patur korrespondence me palen paditese dhe ka kthyer pergjigje kerkesave te saj. Nderkohe, pala padites gabohet kur pretendon se i eshte kufizuar e drejta e pronesisë, si nje e drejte kushtetuese dhe nje e drejte e parapare ne K*DNJ. Ne fakt, ne asnje moment, as ne ligjin per trashegimine kulturore, as ne urdher jo e jo, nuk thuhet se me deklarimin e nje pasurie si monument kulture, perben kufizim te perdorimit apo gezimit te pasurise nga pronari apo poseduesi-t, perkundrazi, sikurse edhe e ka informuar MK palen paditese, ne shkresen nr. 2159 Prot. date 20.05.2020, ashtu sikunder e ka theksuar serish ne nje komunikim tjeter qe ka patur me palen paditese, konkretisht me shkresen nr. 1981/1 Prot., date. 19.06.2020, duke u shprehur se: " Status i "Pasuri kulturore " nuk ndikon as ne titullin e pronesisë dhe as ne te drejtat e perdorimit te prones ne funksionin ekzistues. Ky status i jep nje rendesi te vegante objektit qe mbart keto vlera kulturore. Keshtu, pala paditese, nuk ka pse te ndjehet e rrezikuar duke menduar se me ane te ketij urdhri po i kufizohet (apo do ti kufizohet ne te ardhmen) e drejta e pronesisë, pasi sikurse permendem dhe me lart, si dhe ne respektim te ligjit 27/2018, Z. ***** , nuk do te cenohet/kufizohet ne asnje moment ndonje prej tagrave te pronesisë, sikurse jane: e drejta e posedimit, gezimit dhe posedimit. Ajo cfare "lind" nga i gjithë ky urdher, per te cilen pala paditese eshte keqkuptuar-sikur do t'i merret apo cenohet pasuria, gje qe nuk eshte e vertete-eshte vetem se me ane te ketij urdhri nderohet dhe vleresohet puna e te ndjerit z. Maks ***** , duke i dhene keshtu nje status te vegante baneses ku ai jetoi, dhe se kjo pasuri duke marre statusin Monument Kulture Kategoria ***** -te, do te jete edhe nen kujdesin dhe mbrojtjen e MK-se, si dhe nga poseduesi-t, pronari-et e kesaj pasurie, ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitive te ligjit 27/2018, kerkohet qe te ruaj-ne dhe te mbroj-ne kete pasuri si dhe vlerat qe ajo mbart, si dhe te bashkepunoj-ne me institucionet e specializuara per te kryer mbrojtjen, ruajtjen e pasurise kulturore. Gjithashtu, kerkohet qe pronari apo poseduesi te siguroje mbeshtetje institucioneve te specializuara qe te ushtrojne kompetencat e tyre te percaktuara me ligj, si dhe fdo kerkese tjeter te parashikuar drejtperdrejte ne ligjin per trashegimine kulturore, pa renduar apo veshtirsuar poziten financiare te pronarit apo poseduesit te pasurise. Nderkohe nga ana tjeter, me deklarimin pasuri kulturore te baneses ku jetoi i ndjeri z. Maks ***** , pala paditese i lind e drejta te perfitoje konsultime, ekspertiza dhe rekomandime nga autoritet kompetente per ruajtjen e pasurive kulturore, si dhe te perfitoje mbeshtetje financiare, ne kuader te programeve qe kane te bejne me ruajtjen, konservimin, restaurimin dhe mirembajtjen e pasurive kulturore, te financuara nga buxhetet e qeverisjes qendrore, vendore apo burime te tjera te ligjshme.

-Pala paditese, kerkon shfuqizimin e urdherit objekt gjykimi pasi nuk eshte dakord me vendimarrjen dhe procedurat e ndjekura, te cilat ne vleresimin e paditesit, bejne qe ky urdher te jete nxjerre ne kundërshtim me ligjin material dhe ate procedural. Sa i perket ketij pretendimi, sjellim ne vemendje te gjykates se per miratimin e ketij urdhri, dhe proceduren e ndjekur per deklarimin e pasurise Monument Kulture Kategoria e ***** MK eshte referuar dhe ka zbatuar ligjin 27/2018, si ligji material dhe procedural, ku ne te parashikohet se eshte kompetence e Ministrit pergjegjes per trashegimine kulturore qe te deklaroje (me ane te urdherit) nje pasuri si monument kulture, pas ndjekjes se nje procedure si dhe



R* PUBLIKA * SHQIPERISE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare
Tirane

nismes/propozimit te procesit te verifikimit dhe deklarimit te nje pasurie si pasuri kulturore.
***** ne nxjerrjen e urdherit qe kerkohet te shfuqizohet, ka respektuar ne menyre korrekte ligjin material dhe ate procedural. Duke u nisur nga pretendimet qe pala paditese parashtron ne kerkesen e saj si dhe nga verifikimi i plote i procedures dhe bazes ligjore te ndjekur per deklarimin e pasurise se paluajtshme si Monument Kulture, konkludojme se nuk jemi para kushteve per shfuqizimin e nje akti administrativ. Sipas nenit 17 te ligjit 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreshjeve administrative ", te ndryshuar, percaktohet: "Padia ngrihet: a) per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ Pikerisht kete kekon dhe pala paditese shfuqizimin e aktit administrativ, ne kete rast, te urdhrin nr. 163/2020, duke e konsideruar si akt administrativ te paligjshem, mirpo per te pare nese jemi apo jo para rasteve se kur mund te kerkohet te shfuqizohet nje akt asministrativ, vlem te merret ne konsiderate se qfare parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative, ku jane te mirepercaktuar rastet se kur mund te kerkohet shfuqizimi i nje akti administrativ. Keshtu, sipas nenit 116, thuhet: "Nje akt administrativ eshte i paligjshem nese:

organi publik qe e ka nxjerre ka vepruar ne mungese te kompetences;

eshte rezultat i shkeljes te dispozitave lidhur me proceduren administrative;

eshte ne kundersizim me dispozitat qe rregullojne formen apo elementet e detyrueshme te aktit administrativ;

q) eshte nxjerre ne mungese te autorizimit nga nje ligj, sipas pikes 2, te nenit 4, te ketij Kodi;

eshte ne kundersizim me ligjin material;

dh) eshte rezultat i diskrecionit te ushtruar ne menyre jo te ligjshme; apo

nuk eshte ne perputhje me parimin e proporcionalitetit. "

Ne kuptim dhe interpretim te kesaj dispozite, nuk jemi ne kushtet kur akti administrativ, ne kete rast urdhri objekt gjykimi, te jete akt administrativ i paligjshem, pasi eshte kompetence e Ministrise se ***** , ne mbeshtetje te nenit 62 te ligjit 27/2018, te miratoje me urdher deklarimin e nje pasurie si monument kulture. Gjithashtu, eshte respektuar aspekti procedural ne nxjerrjen e urdhrin nr. 163/2020, konkretisht nenet 57, 58, 59, 60, 61 dhe 62 te ligjit 27/2018, si dhe ky urdher permban te gjitha elementet e domosdoshem per te qene i ligjshem, aspekt per te cilin dhe pala paditese nuk ka kundersizim. Po ashtu, urdhri nuk eshte nxjerre ne mungese te autorizimit te nje ligji, pasi eshte vete ligji 27/2018, qe i njeh te drejten Ministrise se ***** , qe me respektimin e procedures ligjore te parapare po ne kete ligj, te mund te deklaroje nje pasuri si Monument Kulture (pika 3 e nenit 62 ,te ligjit 27/2018). As sa i perket ligjit material, urdhri qe kerkohet te shfuqizohet nuk eshte ne kundersizim me te. Keshtu, ligji material ku eshte mbeshtetur dalja e ketij urdhri, eshte ligji 27/2018, dhe se permbajtja e urdherit, nuk vjen ne kundersizim me dispozitat e ligjit ne fjale, aspekt per te cilin dhe pala paditese nuk ka kundersizim ne sa shprehet ne kerkesen e saj. Sa i perket nese jemi para kushteve te ushtrimit te diskrecionit ne menyre te paligjshme nga ana e Ministrise se ***** , para se te shprehemi per kete pike, kujtojme se ne KPrA te Republikes se Shqiperise, konkretisht, pika 3 e nenit 3, jepet perkufizimi i diskrecionit te organit publik, si: "Diskrecioni i organit publik" eshte e drejta e ketij te fundit per te ushtruar autoritet publik per te permbushur nje qellim te ligjshem, ne rastet kur ligji parashikon pjeserisht modalitetet per te arritur kete, duke i dhene hapesine vleresimi zgjedhjeve te organit publik. " Pikerisht, ***** e ***** , ne permbushje te detyrave dhe nje qellimi te ligjshem, ku nder te tjera eshte dhe ajo e mbrojtjes se pasurive kulturore, dhe per realizimin e mbrojtjes se tyre, ne rastin konkret te pasurise se paluajtshme objekt gjykimi, MK e deklaroi ate si Monument



R* PUBLIKA * SHQIPËRISË *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Kulture te Kategorise se ***** dhe njehere qe deklarohet si e tille, veprojne dispozitat e ligjit per trashegimine kulturore dhe muzete, qe parashikojne nje mbrojtje me te gjere te objekteve pasuri kulturore.

-Duke e aplikuar ne rastin konkret parimin e proporcionalitetit, se pari duhet thene se veprimi administrativ i Ministrise se ***** , urdhri nr. 163/2020, duke qene se nuk kufizon ndonje te drejte individuale apo cenone interesea legjitime te pales paditese, ashtu sikurse shpjegohet dhe me siper, pasi qe deklarimi si pasuri kulturore te pasurise se paluajtshme ne pronesi te pales paditese, nuk cenon tagrat e tij te pronesise, atehere, per rrjedhoje nuk jemi para kushteve ku ne nxjerrjen e urdhrimit te behet testi i proporcionalitetit. Por edhe nese do te konsideronim se ne nje menyre a tjeter, pala paditese do te cenohet ne gezimin, posedimin apo disponimin e pasurise kulturore ne pronesi te tij, gje qe eshte absolutisht e pavertete, megjithate ky urdher ploteson kriteret per te qene ne perputhje me parimin e proporcionalitetit. Keshtu, dhe ne rastin e pasurise se deklaruar Monument Kulture, ne pronesi te pales paditese, pas nje vleresim te bere nga ana e MK-se dhe institucioneve te specializuara ne varesi te saj, ka dale ne perfundimin se objekti "Banesa ku ka jetuar Maks Veto, rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane,, paraqet vlera kulturore. Me konkretisht, ky urdher ka nje qellim te ligjshem qe eshte ai i mbrojtjes se objekteve qe paraqesin vlera kulturore, duke e arritur ate (mbrojtjen) me mjetet dhe masat qe cenojne sa me pak te drejtat apo interesat legjitime te pales paditese mbi pronen e tij, pa i nderhyre apo cenuar tagrat e pronesise, si dhe ky urdher eshte i nevojshem dhe mjete i vetem i pershtatshem per synimin qe kerkohet te arrihet: mbrojtja e objektit te deklaruar Monument Kulture.

Lidhur me bazueshmërinë e kërtimeve të paditësit, gjykata i referohet ligjit nr. 27/2018, "Per trashegimine kulturore dhe muzetë" si dhe vendimit unifikues nr.3 datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në vendimin unifikues nr.3 datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është arsyetuar se: *"Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrihen në kërkesëpadi si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të K.Pr.C. objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmbledhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit iura novit curia, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve. Nëse gjykata konstaton se pretendimet e paditësit, d.m.th. objekti i padisë dhe shkaku i saj, gjejnë mbrojtje ligjore atëherë e pranon padinë, në rast të kundërt padia rrëzohet.*

Në këndvështrim të këtij vendimi unifikues, duke marrë në konsiderat përmbajtjen e kërkesëpadisë, gjykata identifikon kërkimin e palës paditëse. Në thelb, kërkitimi i palës paditëse ka të bëjë me shfuqizimin e akteve administrative, objekt gjykimi, për shkak të paligjshmërisë së tyre.

Sic ka rezultuar, paditësi ***** është pronar i pasurisë së paluajtshme të llojit shtëpi banimi, të ndodhur ne Rrugen "Hoxha Tahsim", me nr. pasurie 2/209, regjistruar ne vol. 26, faqe 191, Zona Kadastrale 8150, Tirane.

Me vendimin nr.130 datë 08.05.2020, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka vendosur:



R*PUBLIKA*SHQIPËRISË*

Gjykata Administrative e Shkalles se pare
Tirane

- *Miratimin e deklarimit pasuri kulturore e objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane".*

Ndërsa me urdhrin nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", ***** ka urdhëruar:

1. *Deklarimin pasuri kulturore, Monument Kulture Kategoria e ***** objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane"...*

Këto akte administrative janë bazuar në ligjin nr. 27/2018, "Per trashegimime kulturore dhe muzete", i cili ka për qëllim të tij, ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitjen e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore (neni 1 i ligjit).

Ndërsa në nenin 2 të këtij ligji është përcaktuar objekti i tij. Sipas kësaj dispozite: *Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Përsa i përket përkufizimit "Monument kulture të kategorisë *****", është deklaruar pasuria e paluajtshme nr. 57/2", e ndodhur në rrugën "Hoxha Tahsim", Tiranë, gjykata i referohet gërmës b) të pikës 36 të nenit 5 të ligjit nr. 27/2018, "Per trashegimime kulturore dhe muzetë", në të cilën parashikohet se:

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

b) *"Monument kulture i kategorisë ***** është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.*

Cështja që shtrohet për zgjidhje pranë kësaj gjykate është nëse pasuria e paluajtshme nr. 57/2", e ndodhur në rrugën "Hoxha Tahsim", Tiranë përmbush apo jo kriteret për t'u konsideruar ndërtim me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.

Në respektim të detyrimeve procedurale të përcaktuara në nenin 35 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative",: 1. *Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.*

Në këndvështrim dhe mbështetje të këtij parashikimi ligjor, palët e paditura nuk kanë provuar para gjykatës ligjshmërinë e aktit administrativ, si dhe faktet që ai kanë parashtruar dhe kanë vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Konkretisht, palët e paditura nuk kanë paraqitur prova shkresore me të cilat të provohej fakti se, pasuria e paluajtshme nr. 57/2", e ndodhur në rrugën "Hoxha Tahsim", Tiranë përmbush kriteret për t'u konsideruar ndërtim me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme (gërma b) e pikës 36 të nenit 5 të ligjit nr. 27/2018, "Per trashegimime kulturore dhe muzetë").



R*PUBLIKA*SHQIPËRE*

**Gjykata Administrative e Shkalles se pare
Tirane**

Po kështu, veprimtaria administrative e palëve të paditura për deklarimin e pasurisë kulturore, monument kulture kategoria e ***** të objektit "Banesa ku ka jetuar Maks ***** rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", bie ndesh dhe me parimin e sigurisë juridike, i cili është një nga elementët më të rëndësishëm të parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.

Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (shih vendimin nr.20, datë 15.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin konkret gjykata i referohet dhe Vendimit nr.3/2018 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin është arsyetuar se: *Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik (shih vendimin nr.25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i këtij parimi, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara (shih vendimin nr.10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

Në këndvështrim të kësaj jurisprudence kushtetuese, veprimtaria administrative e palës së paditur që ka të bëjë me deklarimin e pasurisë kulturore, monument kulture kategoria e ***** të objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", ka cënuar parimin e sigurisë juridike pasi kjo veprimtaria administrative ka prodhuar pasoja negative për paditësin, duke kufizuar të drejtën e pronësisë, aspekt shumë i rëndësishëm i të cilës është disponimi i saj (pronësisë) si dhe e drejta për ta zhvilluar atë (pronësinë), në bazë të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Ndërsa me vendimin nr.11/2018, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: *18. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i këtij parimi, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (shih vendimin nr.10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

Mbështetur, në këtë arsyetim, i cili ka forcën e ligjit (shih vendimin nr.18, datë 14.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese), gjykata cmon se e drejta e pronësisë së paditësit nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt". Në rastin konkret, pala e paditur nuk ka zhvilluar një proces të rregullt administrativ, nëpërmjet të cilit të deklarohej pasuri kulturore, monument kulture kategoria e ***** të objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane". Konkretisht nga palët e paditura nuk është provuar që t'i jetë dhënë mundësia paditësit, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur gjatë procesit administrativ që ka të bëjë me deklarimin e pasurisë kulturore, monument kulture kategoria e ***** të objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane".

Pra, nga tërësia e kësaj veprimtarie administrative, gjykata vlerëson se pala e paditur ***** e Kulturës nuk ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ (vendimi nr.7 dt,27.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese), pasi nuk i ka dhënë mundësi paditësit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në këtë proces, i cili në thelb kufizon të drejtën e pronësisë, aspekt



R* PUBLIKA * SHQIPËRIE *

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

shumë i rëndësishëm i të cilës është disponimi si dhe e drejta për ta zhvilluar atë, në bazë të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Përsa mësipër, gjykata cmon se Urdhri nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", i Ministrit te ***** dhe vendimi nr.130 datë 08.05.2020 i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 27/2018, "Per trashegimine kulturore dhe muzetë", dhe si të tillë duhen shfuqizuar, kjo, në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 49/2012 datë 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", në të cilin parashikohet se; 1. Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos:a) shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe prova, duke u vendosur shfuqizimi i Urdhrit nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", të Ministrit te ***** dhe vendimit nr.130 datë 08.05.2020 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

PËR KËTO ARSY *****

Gjykata bazuar në nenet 40, 41, 42 të ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", nenet 306-310 të K.Pr.Civile.

Për keto arsye:

.Baza Ligjore:

Vendosi:Pranimin e padisë.

- Shfuqizimin e Urdhrit nr. 163, date 08.05.2020 "Per deklarimin e pasurise kulturore te objektit "Banesa ku ka jetuar Maks *****", rruga "Hoxha Tahsim", nr. 57/2" Tirane", të Ministrit te ***** dhe vendimit nr.130 datë 08.05.2020 të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall sot më datë 26.10.2020, Tiranë

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.